



Përtej retorikës politike

**Kthimi i Komisionit Parlamentar për Integrim European në
udhëheqës të vërtetë të integritit**

Komentarët e KCSF-së janë punime të shkurta, të orientuara drejt zgjidhjeve që shqyrtojnë çështjet kyçe që hyjnë në misionin e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile. Secili punim vë në pah sfidat kryesore të qeverisjes dhe u ofron vendim-marrësve ose hisedarëve të rëndësishëm sygjerime praktike për t'i përmirësuar ose tejkaluar këto sfida.

Qershor 2015

Botuar nga KCSF dhe përgatitur nga:

Autore

Kaltrina Hoxha

Bashkëautor

Taulant Hoxha

Kontribues

Venera Hajrullahu

Fatmir Curri

Ky publikim është përkrahur financiarisht nga Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD). Njësia e Hulumtimeve të KCSF-së përkrahet nga Fondi për Institute Hulumtuese i Fondacionit për Shoqëri të Hapur (OSF TTF).

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Trustit Ballkanik për Demokraci apo Fondit për Institute Hulumtuese të Fondacionit për Shoqëri të Hapur.

E drejta autoriale © 2015. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Qershor 2015

Hyrje

Kuvendi i Kosovës është organi më i lartë legjislativ i vendit, e si i tillë ka rol qendror në procesin e integritit evropian të Kosovës. Kuvendi ka mandatuar Komisionin për Integrim Evropian (më tej KIE) për: (1) mbikëqyrjen e harmonizimit dhe përafritit të legjislacionit kosovar me atë të BE-së; (2) mbikëqyrjen e punës së Qeverisë e institucioneve tjera publike në procesin e integritit evropian; dhe (3) bashkëpunimin me vende anëtare të BE-së dhe vende e forume tjera nëpërmjet diplomacisë parlamentare. Edhe pse ka hyrë në vitin e tetë të funksionimit, ky komision ende nuk po arrin që të ushtrojë si duhet mandatin për të cilin është themeluar.

Integrimi evropian gëzon përkrahje të gjerë politike e popullore. Në të vërtetë, përkushtimi për t'u integruar në BE është një nga çështjet e pakta që i bashkon shumicën e partive politike. Për të shndërruar përkrahjen deklarative në rezultate konkrete, është e domosdoshme që Kuvendi të krijojë parakushtet e nevojshme që Komisioni për Integrim Evropian të funksionojë në mënyrë efektive. Siç theksohet edhe në Raportin e Progresit për Kosovë i vitit 2014, "...funksionimi i Komisionit për Integrim Evropian duhet të përmirësohet në mënyrë që të reflektohet roli tij i rëndësishëm në procesin e integritit evropian të Kosovës."¹

Nëpërmjet këtij *Komentari*, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) paraqet disa parakushte kryesore – në formë rekomandimesh – për t'i mundësuar KIE-së që të ushtrojë mandatin që i takon. Të gjitha rekomandimet rezultojnë të jenë lehtë të zbatueshme, me kusht që të ekzistojë vullneti i duhur politik për ta ngritur cilësinë e punës së KIE-së dhe Kuvendit në këtë proces strategjik për të ardhmen e vendit. Gjatë viteve të kaluara, vullneti politik ka qenë kryesisht deklarativ. Me avancimin e Kosovës në procesin i integritit evropian, përfshirë edhe zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, do të jetë e domosdoshme që retorika politike në përkrahje të integritit në BE të përkthehet në investim serioz politik, njerëzor dhe financiar. Vullneti politik mbetet parakushti më i rëndësishëm i zbatimit të secilit rekomandim të dhënë më poshtë në këtë *Komentar*.

ROLI LEGJISLATIV

KIE duhet të rrisë kapacitetet e veta për shqyrtimin e projektligjeve nga aspekti i përafrimit dhe harmonizimit me legjislacionin e BE-së – acquis

Në vitin 2008 Kuvendi i Kosovës ka themeluar Komisionin për Integritet Europian, si Komision të përhershëm të Kuvendit. Komisioni i legjislaturës së pestë u miratua në dhjetor të vitit 2014.² Bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, por edhe në Planin e Punës të Komisionit për vitin 2015, ndër përgjegjësitë prioritare është shqyrtimi i projektligjeve për miratim në Kuvend nga aspekti i përafrimit dhe harmonizimit me legjislacionin e BE-së, përkatesisht me legjislacionin e BE-së – acquis.³

“Për mbi 90% të projektligjeve të cilat i shqyrton, KIE nuk ka ndihmë profesionale ose ligjore nga jashtë, por duhet t’i mbulojë me kapacitetet e veta. Po të kishte numër më të madh të stafit mbështetës në dispozicion të KIE-së, Qeverisë do t’i ktheheshin më shumë projektligje. Numri i madh dhe i ndryshëm i temave të projektligjeve e bën të pamundur që me kapacitetet ekzistuese të kufizuara KIE të ketë njohuri dhe ekspertizë për të gjitha ato.” - Vjosa Osmani.¹

Çdo projektligj që dorëzohet në Kuvend nga Qeveria e ka të bashkëngjitur “Deklaratën e përputhshmërisë”, të lëshuar nga Ministria e Integritet Europian (më tej MIE). Kjo deklaratë konfirmon që projektligji përkatës është në pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së.⁴

Edhe pse të rralla, megjithatë ka pasur raste që KIE ka kthyer projektligje që i ka konsideruar që nuk janë në përputhshmëri me legjislacionin e BE-së – acquis, përkundër Deklaratës së përputhshmërisë nga MIE.⁵

Deputetët anëtarë të këtij komisioni nuk e kanë (dhe nuk pritet që ta kenë) ekspertizën e duhur për secilën temë që trajtohet nga projektligjet përkatëse. Në anën tjetër ndihma nga jashtë është mjaft e kufizuar. Kjo bën që shpesh herë projektligje të ndryshme të kalojnë në KIE pa ndonjë shqyrtim të mirëfilltë. Arsyetim për këtë mund të jetë Deklarata e Përputhshmërisë nga MIE, që konsiderohet që e konfirmon faktin se projektligji është “në rregull me legjislacionin e BE-së – acquis”.⁶

Roli parësor në ofrimin e mbështetjes për Komisionin i takon Administratës së Kuvendit, e cila ka për detyrë ofrimin e mbështetjes profesionale, administrative dhe teknike për nevojat e Kuvendit, të Kryesisë, të Komisioneve, të grupeve parlamentare dhe të deputetëve të Kuvendit.⁷ KIE ka një staf mbështetës të veçantë prej katër personash, e që udhëhiqet nga një koordinator.⁸ Ky staf mbështetës është burimi kryesor i ndihmës për rolin legjislativ të KIE-së. Megjithatë, duke marrë parasysh numrin e madh të projektligjeve të shqyrtuara dhe llojllojshmërinë e temave të trajtuara, ky numër i stafit mbështetës është i pamjaftueshëm për t’i plotësuar nevojat tematike dhe ligjore të KIE-së.⁹ Për shembull, në vitin 2013 - viti i fundit i plotë kur Kuvendi ishte aktiv - janë miratuar 56 projektligje,¹⁰ ndërsa në vitin 2015, 113 projektligje janë planifikuar për miratim.¹¹

“Në Administratën e Kuvendit ka disproporcion në mes stafit teknik dhe atij profesional. Njësia për Harmonizim dhe Përafrim Ligjor ka mungesë ekspertize dhe nuk mund të shfrytëzohet sa duhet nga KIE.” - Ilir Deda.²

¹ Osmani, Vjosa; Anëtare e Komisionit për Integritet Europian të Kuvendit të Kosovës. Intervistë 27-04-2015.

² Deda, Ilir; Anëtar i Komisionit për Integritet Europian të Kuvendit të Kosovës. Intervistë 23-03-2015.

Rekomandimi 1.1

Si komision fusha e të cilit është prioriteti kryesor strategjik i vendit, KIE duhet të kërkojë nga Kuvendi burimet e domosdoshme për të angazhuar numër dhe cilësi të mjaftueshme të stafit mbështetës. Kjo duhet të përfshijë edhe angazhimin e profesionistëve të politikave të ndryshme të BE-së, për të mbuluar në mënyrë cilësore gamën e gjerë të fushave që trajtohen nga projektligjet në shqyrtim.

Një burim tjetër i brendshëm i mbështetjes për KIE është edhe Njësia për Harmonizim dhe Përafrim Ligjor e Kuvendit në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme për çështje ligjore dhe procedurale. Kjo Njësi, me tre zyrtarë ligjorë në dispozicion, është në dispozicion të të gjitha Komisioneve të Kuvendit. Ngjashëm me stafin mbështetës të KIE-së, edhe kjo njësi ka kapacitete të pamjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha temat e trajtuara me legjislacionin e BE-së – acquis.¹²

Burim i tretë i brendshëm i mbështetjes për KIE është edhe Njësia për Hulumtime e Kuvendit, e cila bën hulumtime për tema të caktuara, me kërkesë të Komisioneve. Kjo Njësi ka momentalisht katër zyrtarë ligjorë për hulumtime.¹³ Edhe kjo Njësi ka mungesë të kapaciteteve për të prodhuar hulumtime cilësore dhe në kohë. Sa për ilustrim, deri në Prill 2015, KIE ka porositur nga kjo Njësi vetëm një hulumtim, të cilin megjithatë nuk e ka pritur të kompletohet, për shkak të kohës së gjatë për t'u përfunduar.¹⁴

Një nga mundësitë shtesë të angazhimit të ekspertëve të jashtëm ofrohet nga një projekt për përkrahjen e hulumtimeve parlamentare, që zbatohet nga KDI me mbështetjen e USAID. Duke kontraktuar ekspertizë dhe hulumtues të jashtëm dhe të pavarur të fushave të ndryshme bazuar në kërkesën e Komisioneve, ky projekt synon ta ndihmojë Kuvendin që të miratojë ligje sa më cilësore e të zbatueshme.³

Rekomandimi 1.2

KIE duhet të rrisë presionin në pjesën tjetër të Administratës së Kuvendit të Kosovës, përfshirë Njësinë për Hulumtime dhe atë të Harmonizimit dhe Përafrimit Ligjor, për rritje të cilësisë, por edhe të shpejtësisë, së punës në aspektin e përafrimit dhe harmonizimit të legjislacionit me atë të BE-së.

Përveç kapaciteteve të brendshme, Kuvendi i Kosovës synon të shfrytëzojë edhe kapacitetet dhe ekspertizën e jashtme. Sipas Planit të Punës për vitin 2015, një nga prioritetet e KIE është angazhimi i ekspertëve nga jashtë dhe bashkëpunimi i ngushtë me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare nga fusha e integritit evropian.¹⁵ Në praktikë, bashkëpunimi me shoqërinë civile mbetet i kufizuar. Një takim me shoqërinë civile i paraparë të mbahet në shkurt 2015 ende nuk është mbajtur,¹⁶ edhe pse është takimi i vetëm i planifikuar përgjatë gjithë vitit. Kuvendi i Kosovës ka një databazë funksionale të organizatave jo-qeveritare të cilat kanë shprehur interesimin e tyre për të bashkëpunuar me këtë institucion, përfshirë komisionet e veçanta parlamentare. Për t'u përfshirë në punën e KIE-së, deri në fund të muajit maj 2015, kanë shprehur interesimin 20 organizata të shoqërisë civile.¹⁷ Shumë nga to janë mjaft të njohura për punën e tyre profesionale në sektorë të veçantë. Kjo listë paraqet nivelin e parë, por jo të vetmin, me të cilin KIE do të mund të fillonte një dialog të vazhdueshëm dhe të strukturuar për të shfrytëzuar ekspertizën e jashtme në përmbushjen e misionit të vet. Kjo gjithashtu do t'i ishte në përputhje me drejtimin strategjik të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, nëpërmjet Deklaratës për partneritet në mes të Kuvendit të Kosovës dhe shoqërisë civile, të miratuar në prill të vitit 2014.¹⁸

³ Faqja e internetit e projektit për hulumtime parlamentare http://kdi-kosova.org/hulumtime_parlamentare/ (E vizituar më 30-04-2015).

Rekomandimi 1.3

KIE duhet të fillojë një dialog të strukturuar me shoqërinë civile, përfshirë organizimin e dëgjimeve publike për secilin projektligj në procedurë, me qëllim të plotësimit të ekspertizës së nevojshme për shqyrtim profesional të gjithë pakos së gjerë e komplekse të projektligjeve të cilat shqyrtohen nga KIE.

Rekomandimi 1.4

KIE duhet t'iu qaset donatorëve ndërkombëtarë në Kosovë për t'iu kërkuar përkrahje për angazhim të ekspertëve ligjor e politik, për ta ndihmuar KIE-në që të përmbushë efektivisht misionin e vet. Kjo duhet të bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse të nevojave, të ndërmarrë nga KIE.

ROLI MBIKËQYRËS

KIE duhet të jetë më sistematike dhe kërkuese në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë në procesin e Integritimit European

Një nga aspektet kryesore të punës së Kuvendit është roli i tij mbikëqyrës, sidomos në raport me punën e Qeverisë. Prioriteti i KIE-së është mbikëqyrja e procesit të harmonizimit dhe përafrimit të legjislationit të Kosovës me legjislationin e BE-së – *acquis*.¹⁹

Një nga parakushtet për një mbikëqyrje të duhur është komunikimi i rregullt i dyanshëm i KIE-së me ministrinë të cilat janë të përfshira në procesin e integritimit european, në veçanti me MIE-në. Sipas MIE-së, përveç raportimeve të rregullta para KIE-së, Ministri i Integritimit European ka komunikim të përditshëm koordinues me këtë komision, ndërsa MIE-ja ndan dokumente të ndryshme rreth procesit të integritimit european.²⁰ Por anëtarë të KIE-së theksojnë që as MIE e as ministrinë tjera nuk kanë ndarë informata me KIE-në në baza të rregullta.²¹ Rasti i mos-ndarjes së draftit të MSA-së me të gjithë anëtarët e KIE-së (të paktën deri në fillim të muajit maj 2015) vetëm sa e ilustron këtë problematikë.

Edhe pse është kërkuar nga anëtarët e KIE-së, teksti i draftit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, është ndarë vetëm me Kryetaren e KIE-së,⁴ por jo edhe me anëtarët tjerë të këtij komisioni.⁵

ministrinë të cilat janë të përfshira në procesin e integritimit european, në veçanti me MIE-në. Sipas MIE-së, përveç raportimeve të rregullta para KIE-së, Ministri i Integritimit European ka komunikim të përditshëm koordinues me këtë komision, ndërsa MIE-ja ndan dokumente të ndryshme rreth procesit të integritimit european.²⁰ Por anëtarë të KIE-së theksojnë që as MIE e as ministrinë tjera nuk kanë ndarë informata me KIE-në

KIE mund të kërkojë edhe të dhëna konkrete, duke përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të Ministrave ose personave të tjerë përgjegjës.²² Nëse Ministri i thirrur nuk raporton, KIE mund të kërkojë që kjo të hyjë në rendin e ditës së mbledhjes tjetër plenare.²³ Në këtë legjislaturë, dhe jo vetëm, nuk janë të rralla rastet kur ministrat e thirrur për të raportuar nuk paraqiten. Duke mos i shfrytëzuar instrumentet ligjore në dispozicion për rastet e injorimit të KIE-së nga ana e Qeverisë, çështja e raportimit në KIE (dhe Komisione

“Mbikëqyrja parlamentare është e politizuar dhe në përgjithësi ka pak iniciativë për t’i sfiduar ministrat përgjegjës.”- Rinor Beka.⁶

⁴ Sahatqija, Teuta; Kryetare e Komisionit për Integritime Europiane. Korrespondencë. 08-05-2015.

⁵ Vjosa; Anëtare e Komisionit për Integritime Europiane të Kuvendit të Kosovës. Intervistë 27-04-2015.

⁶ Beka, Rinor; National Democratic Institute (NDI). Programi Legjislativ, Menaxher i lartë i programit. Intervistë 31-03-2015.

tjera) duket që mbetet në vullnetin e lirë të ministrave, e jo si një obligim ligjor e demokratik ndaj organit më të lartë të shtetit. Ky trend duhet të ndërpritet.

Rekomandimi 2.1

KIE duhet të shfrytëzojë mekanizmat ligjorë në dispozicion për të detyruar ministrinë dhe institucionet tjera të thirrura që proaktivisht të ndajnë me të gjithë anëtarët e KIE-së të gjitha dokumentet relevante për procesin e integritit evropian, si dhe të raportojnë para KIE-së sa herë që një gjë e tillë i'u kërkohet.

Rekomandimi 2.2

KIE duhet të ndërtojë një sistem funksional të mbikëqyrjes i cili siguron që: (1) takimet me ministra mbahen sa herë që është e nevojshme dhe në mënyrë profesionale; (2) veprimet pasuese pas takimeve dhe raportimeve në KIE ndodhin në mënyrë të duhur; (3) mbikëqyrjen sistematike të zbatimit të dokumenteve të rëndësishme për procesin e integritit evropian.

E lidhur me raportimin është edhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave, ligjeve, strategjive apo marrëveshjeve të cilat kanë të bëjnë me procesin e integritit evropian. Nuk është e pazakontë që pas raportimit të ministrit të caktuar për një dokument specifik, KIE të mos ndërmarrë asnjë veprim pasues për ta përcjellë më tej atë çështje.²⁴ Ngjashëm, KIE nuk e shfrytëzon si duhet as pjesëmarrjen në Këshillin Kombëtar për Integritim Evropian, si një mundësi shtesë për të kërkuar llogari për reformat e dokumentet që dalin nga vet ky Këshill.

Me MSA-në që pritet të hyjë në fuqi së shpejti, pritet për mbikëqyrjen efektive të zbatimit të kësaj marrëveshje rriten të gjitha palët e anës kosovare. I gjithë procesi i ndërlidhur me MSA-në nuk kërkon vetëm harmonizim të ligjeve, por edhe zbatim të marrëveshjes. Ngjashëm me të gjitha vendet që e kanë kaluar këtë proces, edhe në rastin e Kosovës do të krijohen disa trupa të përbashkët institucionalë në mes të BE-së dhe Kosovës. Përveç Këshillit për Stabilizim Asociim²⁵ (në nivel politik) dhe Komisionit për Stabilizim Asociim²⁶ (në nivel ekspertësh), një Komision Parlamentar për Stabilizim Asociim²⁷ në baza të rregullta do të mbledhë bashkë anëtarët e Parlamentit Evropian dhe të Kuvendit të Kosovës. Përveç si një forum diskutimi ndër-parlamentar, ky Komision mund t'i japë rekomandime Këshillit për

Komisioni Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim në vende tjera

- Është krijuar për secilin shtet, në kuadër të "Marrëveshjes Europiane"⁷ ose "Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit"
- Shpenzimet ndahen nga të dyja palët në mënyrë të barabartë, secila për anëtarët e vet dhe në rastin e organizimit të takimeve nga ana e tyre
- Shërbimet mbështetëse administrative dhe profesionale kryesisht i ngarkohen Administratës që është në mbështetje të KIE-së (Estoni, Lituani, Poloni, Sllovakia, Slloveni)⁸

Stabilizim Asociim për çështje të ndryshme që lidhen me MSA-në. Praktikant e vendeve tjera tregojnë që barra më e madhe e angazhimit të Kuvendit në këtë Komision i bie pikërisht Komisionit për Integritim Evropian, përfshirë stafin mbështetës të këtij komisioni. Nëse nuk do të ketë ndonjë qasje inovative nga Kuvendi i Kosovës për të ndërtuar ndonjë sistem mbështetës të veçantë, atëherë është e domosdoshme që KIE të fillojë sa më parë përgatitjet për këtë angazhim dhe përgjegjësi shtesë.

⁷ Marrëveshja Europiane është marrëveshje në mes të BE-së dhe vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, e barasvlefshme me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për vendet e Ballkanit Perëndimor.

⁸ Në disa shtete, ku Komisionet përgjegjëse për procesin e integritit evropian kanë qenë Komisionet për Punë të Jashtme, shërbimet mbështetëse janë dhënë nga stafi i këtyre komisioneve.

Rekomandimi 2.3

KIE duhet të fillojë menjëherë përgatitjet për të zbatuar obligimet e Kuvendit që dalin nga MSA.

Rekomandimi 2.4

Duke shfrytëzuar pjesëmarrjen në Këshillin Kombëtar për Integrim Europian, KIE duhet të kërkojë përgjegjësi karshi reformave të rekomanduara nga vet ky Këshill dhe të mbikëqyr zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Integrim Europian.

Rikthimi i praktikës së udhëheqjes së Komisionit nga opozita

Roli mbikëqyrës i Kuvendit (dhe Komisioneve) ndaj ekzekutivit i jep këtij institucioni një pozicion të fuqishëm në raport me Qeverinë. Në të njejtën kohë kërkon që KIE ta ushtrojë këtë rol në mënyrë aktive. Duke qenë që integrimi europian paraqet një interes shumë të lartë kombëtar që është përtej agjendave partiake, KIE është në pozicion që të krijojë një barazpeshë në mes të Qeverisë dhe Kuvendit,

“Ideja themelore (e kësaj praktike) është forcimi i konsensusit kombëtar për agjendën e integritit europian dhe qëndrueshmëria e reformave të ndërmarra. Duke përfshirë opozitën në proces dhe duke i’a besuar pozicionin e kryetarit të Komisionit Parlamentar për Integrim Europian, në një mënyrë a tjetër sigurohet përfshirja e opozitës në reformat që kanë lidhje me procesin e integritit europian.”- Ditmir Bushati.⁹

si organ që e mbikëqyr këtë të fundit. Për ta reflektuar rëndësinë e agjendës europiane dhe nevojën e konsensusit mbi-partiak për këtë agjendë, që nga krijimi i KIE-së më 2008 ky komision është udhëhequr nga një parti opozitare. Kjo praktikë është ndërprerë në këtë mandat dhe tashmë KIE udhëhiqet nga njëra nga partitë në pushtet.

Shumica dërmuese e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë ndjekur praktikën e caktimit për udhëheqës të Komisioneve për Integrim Europian të përfaqësuesëve nga partitë opozitare. Një gjë e tillë ndodh aktualisht në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi.²⁸ Ngjashëm ka qenë edhe në Kroaci, para se kjo e fundit të anëtarësohet në BE. I vetmi vend që aktualisht e ka “shkelur” këtë praktikë është Maqedonia, ku

kryesuesi i Komisionit për Integrim Europian vjen nga njëra nga partitë në pushtet.²⁹ Megjithatë, opozita në Maqedoni udhëheq me një trupë tjetër mjaft të rëndësishëm, e që është Këshilli Kombëtar për Integrim Europian, duke krijuar megjithatë një lloj baraspeshe në kontributin dhe pronësinë në këtë proces.³⁰

Rekomandimi 2.5

KIE duhet të rikthejë praktikën e udhëheqjes së komisionit nga një përfaqësues i partive opozitare.

BASHKËPUNIMI PARLAMENTAR

KIE duhet ta ngrisë nivelin e diplomacisë parlamentare

Kosova nuk është njohur nga pesë vende anëtare të BE-së. Kjo i komplikon së tepërmi marrëdhëniet mes Kosovës dhe BE-së, sidomos kur bëhet fjalë për marrëdhëniet kontraktuale. Edhe brenda grupit të shteteve anëtare të cilat e kanë njohur Kosovën, marrëdhëniet nuk janë të njehta me të gjitha. Një nga mënyrat e avancimit të agjendës europiane është shfrytëzimi i marrëdhënieve të mira me një shtet të

⁹ Bushati, Ditmir; Ministër i punëve të jashtme e Shqipërisë, Kryetar i kaluar i Komisionit për integritime europiane në Kuvendin i Shqipërisë. Korrespondencë 17-03-2015.

caktuar anëtar duke e fuqizuar bashkëpunimin ndërparlamentar. Për shkak të fushës të cilën e mbulon dhe mandatit që ka në diplomacinë parlamentare, KIE do të ishte komisioni më i përshtatshëm për ta marrë dhe udhëhequr këtë nismë. Parlamenti i vendit të përzgjedhur do të bëhej “sponzor” i Kosovës në nivele të ndryshme të BE-së dhe të avokonte në emër të Kosovës. Për më tepër, ky sponzor do të mund të ishte një “këshilltar” i dobishëm rreth procesit të integritit evropian në përgjithësi.

Për të identifikuar vendin sponzor, KIE duhet të marrë parasysh: (1) partneritetin e deritashëm të këtij vendi më Kosovën, (2) mbështetjen e ofruar Kosovës në ndërtimin e shtetit dhe përpjekjet për integrim euroatlantik, (3) ekspertizën dhe përvojën në politikat dhe ligjet që prekin shtetet me perspektivë anëtarësimi, (4) mënyra tjera të mbështetjes që mund t’i ofrojë Kosovës. Për më tepër, duhet të mirret parasysh edhe ndikimi i vendit brenda vet strukturave të BE-së, duke synuar vende të cilat kanë peshë më të madhe në marrjen e vendimeve në Këshill, ndikim të dëshmuar në përcaktimin e politikave e vendimeve të BE-së dhe ndikim të shtuar tek vendet tjera anëtare. Bashkëpunimi i veçantë me shtetin sponzor do të përfshinte komunikime të rregullta në mes të KIE-së dhe komisioneve parlamentare përkatëse të vendit sponzor; diskutim të thellë të çështjeve me interes për Kosovën; lehtësim i qasjes së anëtarëve të KIE-së (dhe jo vetëm) në struktura të ndryshme të BE-së ku aktualisht Kosova nuk ka qasje. Për të fuqizuar pozitën e Kosovës në forumet përkatëse të BE-së kur diskutohet për Kosovën, anëtarët e parlamentit të vendit sponzor duhet të ketë informim të duhur dhe të përditëzuar mbi zhvillimet dhe nevojat e vendit.

Rekomandimi 3.1

KIE duhet të shqyrtojë mundësitë më të mira për një bashkëpunim strategjik në procesin e integritit evropian të Kosovës, nëpërmjet identifikimit dhe vendosjes së partneritetit me një “vend sponzor”.

Rekomandimi 3.2

KIE duhet të angazhojë në stafin mbështetës profesionistë të aspekteve politike të integritit evropian, të cilët do të mbështesnin rolin e KIE-së në diplomacinë parlamentare, përfshirë komunikimin dhe bashkëpunimin me “vendin sponzor”.

PËRFUNDIM

Kosova mbetet e ndarë politikisht dhe me një polarizim në rritje. Integrimi evropian është një nga çështjet e pakta që gëzon mbështetje të gjerë popullore dhe politike. Në të vërtetë, agjenda evropiane paraqet një mundësi të artë për të shtyrë përpara bashkërisht çështjet kryesore që e mundëson transformimin e Kosovës. Kjo mbështetje mund të kërkohej jo vetëm nga partitë politike parlamentare, por edhe nga pjesët tjera të shoqërisë. Për vet mandatin që e ka, Komisioni për Integrim Evropian është forumi i duhur për ta kultivuar këtë bashkëpunim dhe për ta përkthyer në një progres kuptimplotë. Në të kundërtën, KIE do të shndërrohet në një makinë të legjitimitit të projekt-ligjeve në raport me standardet evropiane e të thërras për raportim ministra të ndryshëm sa për sy e faqe, pa i mbajtur ata të përgjegjshëm për punën e tyre. Dështimi për të realizuar potencialin e vet dhe për të marrë seriozisht përgjegjësitë që i takojnë më së shumti do t’i kushtojë perspektivës evropiane të vendit dhe mundësive për reforma që bart me vete kjo perspektivë.

Për ta shfrytëzuar potencialin që e ka, KCSF rekomandon që:

- KIE duhet të rrisë kapacitetet e veta për shqyrtimin e projektligjeve nga aspekti i përafrimit dhe harmonizimit me legjislacionin të BE-së, duke rritur numrin dhe cilësinë e stafit mbështetës;
- KIE duhet të jetë më sistematike dhe kërkuese në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë në procesin e Integritit Europian, ndër të tjera edhe duke e rikthyer udhëheqjen e KIE-së nga opozita;
- KIE duhet të përfshijë në punën e vet shoqërinë civile dhe palët tjera, duke e nisur një dialog të strukturuar dhe të vazhdueshëm me këtë sektor;
- KIE duhet ta ngrisë nivelin e diplomacisë parlamentare, duke zgjedhur e bashkëpunuar ngushtë me një “vend sponsor”.

SHTOJCË

Ky *Komentar* paraqet rekomandimet të cilat e ndihmojnë KIE-në që të plotësojë potencialin e vet të plotë të rolit legjislativ, mbikëqyrës dhe atë në diplomacinë parlamentare. Këto rekomandime nuk janë shterruese. Ekzistojnë mënyra tradicionale të përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së, si dhe mënyra tradicionale të mbikëqyrjes politike e ligjore të Qeverisë. Megjithatë, përveç mënyrave klasike, Komisionet Parlamentare për Integrim Europian kanë zhvilluar dhe zbatuar qasje të reja në përmbushjen e rolit të tyre. Më poshtë paraqiten vetëm disa praktika interesante, jo aq për të promovuar ndonjërin prej tyre, sa për të nxitur KIE-në që t’i shqyrtojë disa qasje interesante që mund t’i shfrytëzojë në punën e vet.

Disa praktika nga Komisionet Parlamentare për Integrim Europian³¹

Bisedat me ambasadorët e Hungarisë para nisjes së tyre në mision diplomatik në vendet e BE-së (Hungari).	Komision i veçantë për “Legjislacionin Europian” (Poloni) dhe “Komisioni i përafrimit” (Sllovaki).
Shqyrtim i Raporteve të rregullta të Qeverisë për progresin dhe mbikëqyrje e përmbushjes së obligimeve të marra me Marrëveshjen Europiane (Hungari), respektivisht Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (Mal i Zi).	Përfshirje e personelit të Administratës në grupet negociuese, për secilin nga 33 kapitujt, si anëtarë të plotë dhe kontribues në analizat dhe përgatitjen e pozicioneve të vendit gjatë negociatave (Mal i Zi).
Shqyrtim i raporteve gjashtë mujore nga Qeveria për shfrytëzimin e fondeve të IPA-së (Kroaci).	Organizim i programeve të trajnimeve profesionale për deputetë dhe staf mbështetës mbi çështjet e BE-së (Sllovaki).

Burimet

- ¹ Komisioni Europian. *Raporti i Progresit për Kosovën 2014*. Bashkimi Europian. Komisioni i BE-së Bruksel. 2014:8. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf. (E vizituar më 15-05-2015).
- ² Kuvendi i Republikës së Kosovës. VENDIM-Për formimin e 14 (katërbëdhjetë) Komisioneve Parlamentare. 18-12-2014.
- ³ Republika e Kosovës. Kuvendi. Komisioni për Integritim Evropian. Plani i punës për vitin 2015. 30-01-2015: 5.
- ⁴ Beqiri, Safet; Zyrtar i lartë i fushës/analist në Komision. Kuvendi i Kosovës, Komisioni për Integritim Evropian. Intervistë 24-03-2015.
- ⁵ Osmani, Vjosa; Anëtare e Komisionit për Integritim Evropian të Kuvendit të Kosovës. Intervistë 27-04-2015.
- ⁶ Selmanaj, Driton; Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Hulumtues i lartë. Intervistë 10-03-2015.
- ⁷ Republika e Kosovës. Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës. 29-04-2010: 36. http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_1.pdf. (E vizituar më 15-05-2015).
- ⁸ Republika e Kosovës. Kuvendi. Komisioni për Integritim Evropian. Plani i punës për vitin 2015. 30-01-2015: 5.
- ⁹ Osmani, Vjosa; Anëtare e Komisionit për Integritim Evropian të Kuvendit të Kosovës. Intervistë 27-04-2015.
- ¹⁰ Kuvendi i Kosovës. Kalendari i ligjeve të miratuara në vitin 2013: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,193> (E vizituar më 14-05-2015).
- ¹¹ Kuvendi i Kosovës. Programi i punës i Kuvendit për vitin 2015 (Shkurt 2015).
- ¹² Selmanaj, Driton; Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Hulumtues i lartë. Intervistë 10-03-2015.
- ¹³ Kuvendi i Republikës së Kosovës. Administrata. Organogrami i Kuvendit. <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Organogrami.pdf>. (E vizituar më 12-05-2015).
- ¹⁴ Osmani, Vjosa; Anëtare e Komisionit për Integritim Evropian të Kuvendit të Kosovës. Intervistë 27-04-2015.
- ¹⁵ Republika e Kosovës. Kuvendi. Komisioni për Integritim Evropian. Plani i punës për vitin 2015. 30-01-2015: 3.
- ¹⁶ Osmani, Vjosa; Anëtare e Komisionit për Integritim Evropian të Kuvendit të Kosovës. Intervistë 27-04-2015.
- ¹⁷ Kuvendi i Kosovës. Faqja e internetit e Databazës së Kuvendit për OJQ, me listën e OJQ-ve të interesuara për KIE-në http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,1007&rtpl=ojq_list (E vizituar më 01-06-2015).
- ¹⁸ Deklarata e Partneritetit në mes të Kuvendit të Kosovës dhe shoqërisë civile. http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Deklarata_Kuvendi_Civile.pdf (E vizituar më 14-05-2015).
- ¹⁹ Republika e Kosovës. Kuvendi. Komisioni për Integritim Evropian. Plani i punës për vitin 2015. 30-01-2015: 5.
- ²⁰ Shasha, Demush; Sekretarë i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimeve Evropiane të Kosovës. Korrespondencë 17.04.2015.
- ²¹ Osmani, Vjosa; Anëtare e Komisionit për Integritim Evropian të Kuvendit të Kosovës. Intervistë 27-04-2015.
- ²² Republika e Kosovës. Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës. 29-04-2010: 44. http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_1.pdf. (E vizituar më 14-05-2015).
- ²³ Republika e Kosovës. Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës. 29-04-2010: 33. http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_1.pdf. (E vizituar më 14-05-2015).
- ²⁴ Beka, Rinor; National Democratic Institute (NDI). Programi Legjislativ, Menaxher i lartë i programit. Intervistë 31-03-2015.
- ²⁵ Draft Marrëveshja e Stabilizim Asociim në mes BE-së dhe Kosovës. Dispozitat institucionale, të përgjithshme dhe përfundimtare. Neni 126.
- ²⁶ Draft Marrëveshja e Stabilizim Asociim në mes BE-së dhe Kosovës. Dispozitat institucionale, të përgjithshme dhe përfundimtare. Neni 129.
- ²⁷ Draft Marrëveshja e Stabilizim Asociim në mes BE-së dhe Kosovës. Dispozitat institucionale, të përgjithshme dhe përfundimtare. Neni 132.
- ²⁸ Parlamenti i Shqipërisë. Komisioni për Integritim Evropian. http://www.parlament.al/web/Perberja_10045_1.php. (E vizituar më 15-05-2015).

Parlamenti i Malit të Zi. Committee on European Integration, Composition.

<http://www.skupstina.me/index.php/en/odbor-za-evropske-integracije/sastav>. (E vizituar më 15-05-2015).

Parlamenti i Serbisë. European Integration Committee. <http://www.parlament.gov.rs/national-assembly/composition/working-bodies/committees.56.492.html>. (E vizituar më 15-05-2015).

²⁹ Parlamenti i Maqedonisë. Committee on European Affairs. http://www.sobranie.mk/working-bodies-2014-2018-ns_article-committee-on-european-affairs-2014-en.nsp.x. (E vizituar më 15-05-2015).

³⁰ Tilev, Dragan; Këshilltar i shtetit nga Sekretariati për çështje europiane në Qeverinë e Maqedonisë. Korrespondencë. 19-03-2015.

³¹ Shembujt janë marrë nga studimi “Roli dhe organizimi i Parlamenteve në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian”, Hulumentim i brendshëm i Bibliotekës së Kuvendit të Serbisë. 01-07-2013.



www.kcsfoundation.org